



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 157

Tiranë – E enjte, 3 shtator 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11697, datë 28.8.2020	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10017
Dekret i Presidentit nr. 11699, datë 31.8.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 10017
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 5.8.2020	Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore..... 10017
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 269, datë 28.8.2020	Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private “Kasa”, Durrës..... 10020
Urdhër i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 124, datë 31.8.2020	Për delegim kompetencash..... 10021
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 128, datë 10.8.2020	Mbi kërkesën e shoqërive “Max Energy” sh.p.k., “Windsbab” sh.p.k. dhe “Seman Eolik” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 114, datë 9.7.2020, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi të instaluar deri në 3 MW për vitin 2019”..... 10021
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 129, datë 10.8.2020	Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, “Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit”..... 10024
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 130, datë 10.8.2020	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2020..... 10029
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 131, datë 10.8.2020	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e energjisë elektrike. 10031

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 132, datë 10.8.2020	Mbi kualifikimin dhe pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “Hec Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.....	10032
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 133, datë 10.8.2020	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020 “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”	10033
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 134, datë 10.8.2020	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., nr. 306, seria FK 15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, datë 18.8.2015.....	10034
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 135, datë 10.8.2020	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 71, datë 22.4.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Kalisi Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Veleshica 1”, me kapacitet të instaluar 5801 <i>kW</i> dhe “Veleshica 2”, me kapacitet të instaluar 8116 <i>kW</i> , me kapacitet total të instaluar 13917 <i>kW</i> ”.....	10036

**DEKRET****Nr. 11697, datë 28.8.2020****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, germa “c” dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Evis Avenir Heinrich (Bejo)
2. Alban Shyqiri Horeshka
3. Elona Fadil Horeshka (Merdini)
4. Katerina Kostandin Papa (Maçi)
5. Luljan Myqerem Haskaj
6. Desara Qemal Golemi
7. Elma Arben Kodraj
8. Mario Zamir Kurtezi
9. Donika Frrok Lekaj (Perdoçi/Perdoçi)
10. Gentjana Zenun Alaj
11. Ervin Vesel Demiraku
12. Dafina Hysen Bregu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET**Nr. 11699, datë 31.8.2020****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, germa “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Naim Sylejman Haziri
2. Selvinaze Murat Haziri (Pajaziti)
3. Ardian Hamit Krasniqi
4. Vehbi Muradif Kajtazi
5. Arbnor Shukri Haxhibeqiri
6. Imer Ali Mushkolaj
7. Mentor Qani Mehmedi
8. Zana Skender Bacaj Mehmedi (Bacaj)
9. Valëza Valdet Kastrati
10. Erkan Enver Bolat
11. Murat Cemalettin Gemici

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 18, datë 5.8.2020****PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË
PËRFITIMIT TË PAGESAVE DHE
TARIFAT E SHPËRBLIMIT TË
AVOKATËVE QË OFROJNË NDIHMË
JURIDIKE DYTËSORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 7, shkronja “g”, të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:**I. Objekti**

Ky udhëzim përcakton kriteret e përfitimit të pagesave dhe tarifën e shpërblimit për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore, në përputhje me ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.



II. Kriteret e shpërblimit për shërbimin e ofruar nga avokati

1. Me përfundimin e procedurave të dhënies së ndihmës juridike, avokati duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas formularin për shpërblimin, për ndihmën e ofruar, në përputhje me kontratën vjetore të lidhur midis avokatit dhe kësaj drejtorie.

2. Formulari për shpërblimin për ndihmën juridike shoqërohet me:

- a) faturën tatimore të shërbimit të ofruar;
- b) kopje të vendimit të gjykatave të dhëna për çështjen ose kopje të akteve të tjera, të përpiluara sipas shtojcës 1;
- c) raportin për përfundimin e punës, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

3. Pagesa e shërbimit bëhet përmes llogarisë bankare dhe sipas kushteve të vendosura në kontratën tip të miratuar, siç përcaktohet në ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

4. Në rast se avokati heq dorë nga dhënia e ndihmës juridike dytësore, atij nuk i takon shpërblim për shërbimin e dhënë, sipas kontratës vjetore të shërbimit të lidhur me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, përcaktuar në nenin 24, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Në çdo rast, dhoma vendore menjëherë njofton Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

5. Në rastet e heqjes dorë për raste të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 4, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas njofton Dhomën e Avokatëve të Shqipërisë për vlerësimin e inicimit të një procedimi disiplinor.

III. Tarifat e shpërblimit

Masa e shpërblimit për ndihmën juridike dytësore të ofruar nga avokati, përcaktohet në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

IV. Kompensimi i shpenzimeve

Avokati ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve për shërbimin juridik të kryer. Kompensimi i shpenzimeve bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

V. Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Juridike në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj



SHTOJCA 1

TARIFAT E SHËRBIMEVE JURIDIKE TË AVOKATËVE TË NDIHMËS JURIDIKE

Lloji i shërbimit

Tarifa në lekë

	<u>I. MBROITJA JURIDIKE NË FUSHËN PENALE</u>	Tarifat
1	<u>Përfaqësimi në çështjet penale</u>	
	= Shërbim për ndalimet dhe arrestimet deri në dhënien dhe ndryshimin e masës së sigurimit	15,000
2	<u>Ndihmë juridike për hetimet paraprake deri në dërgimin e çështjes për gjykim</u>	
	= Për kundërvajtjet penale	20,000
	= Për krimet që parashikojnë një dënim deri 10 vjet burgim, në gjykatën e Rr. Gjyqësor	50,000
	= Për krimet që parashikojnë një dënim mbi 10 vjet burgim dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	60,000
3	<u>Ndihmë juridike për gjykimet në shkallë të parë</u>	
	= Për kundërvajtjet penale	20,000
	= Për krimet që parashikojnë një dënim deri 10 vjet burgim, në gjykatën e Rr. Gjyqësor	30,000
	= Për krimet që parashikojnë një dënim mbi 10 vjet burgim, në gjykatën e Rr. Gjyqësor	80,000
	= Për krimet që gjykohen në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	96,000
4	<u>Ndihmë juridike për gjykimet në gjykatat e apelit dhe ajo e Lartë dhe Kushtetuese</u>	
	= Për gjykimet në gjykatat e Apelit	40,000
	= Për gjykimet në gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese	50,000
	<u>II. MBROITJA JURIDIKE NË FUSHËN CIVILE DHE ADMINISTRATIVE</u>	
1	<u>Përfaqësimi në Shkallë të Parë</u>	
	= Përfaqësimi në shkallë të parë, pa palë	15,000
	= Përfaqësimi në shkallë të parë, me palë	40,000
2	<u>Përfaqësimi në Gjykatën e Apelit, atë të Lartë dhe Kushtetuese</u>	
	= Përfaqësimi në Gjykatën e Apelit	45,000
	= Përfaqësimi në Gjykatën Lartë dhe Kushtetuese	60,000
3	<u>Shërbime juridike jashtëgjyqësore</u>	
	= Përgatitje kërkesa ankimore	15,000
	= Përgatitje rekursi për në Gj. Lartë si dhe kërkesë në Gj. Kushtetuese	25,000
	= Ofrim ndihmë juridike në formë këshillimi	500-1500 lek/ora
	<u>III. TË TJERA SHËRBIME AVOKATIE</u>	
	<u>Të tjera shërbime avokatie që mund të mos jenë përfshirë në zërat e mësipërm</u>	



URDHËR

Nr. 269, datë 28.8.2020

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONEVE ARSIMORE
PARAUNIVERSITARE PRIVATE
“KASA”, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26 dhe 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private “Kasa”, Durrës, për të gjitha nivelet arsimore (parashkollor, arsimit fillor, arsimit mesëm i ulët dhe arsimit mesëm i lartë i përgjithshëm), në emër të shoqërisë “Kasa” sh.p.k., përfaqësuar nga z. Jonuz Kasa, i regjistruar si person juridik me vendimin nr. 6299/2, datë 15.9.1994, të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

2. Institucionet arsimore parauniversitare private “Kasa”, Durrës, kanë këto detyrime:

a) Të kthejnë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur, nëse ka.

b) Të pajisin çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar.

c) Të vënë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër.

d) Të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri.

e) Të dorëzojnë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhen institucionet arsimore parauniversitare private “Kasa”, ka për detyrë:

a) Të ngrejë grup pune brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private “Kasa”, Durrës, për të gjitha nivelet arsimore (parashkollor, arsimit fillor, arsimit mesëm i ulët dhe arsimit mesëm i lartë).

b) Të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këto institucione arsimore.

c) Të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga këto institucione arsimore parauniversitare private.

d) Të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dokumentacionin e dorëzuar nga institucionet arsimore parauniversitare private “Kasa”.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast moszbatimi të detyrimeve, përcaktuar në pikën 2, nga personi juridik që përfaqëson institucionin arsimor parauniversitar privat “Kasa”, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 44, datë 13.2.2007, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar: - Shkolla nëntëvjeçare “Kasa”, urdhri nr. 15, datë 17.1.2008, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar: - Kopshti “Kasa” dhe urdhri nr. 14, datë 17.1.2008, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar: - Shkollë e mesme e përgjithshme “Kasa”, shfuqizohen.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës, Zyra Vendore e Arsimit



Parauniversitar Durrës, institucionet arsimore parauniversitare private “Kasa”, Durrës dhe shoqëria “Kasa” sh.p.k.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

URDHËR
Nr. 124, datë 31.8.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Bazuar në nenin 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Emis Çerava, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Burimeve Njerëzore, i komanduar në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, për çështjet e mëposhtme:

1.1 Delegim i kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për kryerjen e të gjitha procedurave të prokurimit publik për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

1.2 Nënshkrimin e autorizimeve për dërgimin me shërbim të punonjësve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, si dhe ato për jashtë territorit të Shqipërisë.

1.3 Nënshkrimin e autorizimeve për përfaqësim ligjor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në emër të personit që do të përfaqësojë Këshillin e Lartë të Prokurorisë në procese gjyqësore.

1.4 Përfaqësimi ligjor i Këshillit të Lartë të Prokurorisë në proceset gjyqësore, sipas pikës 1.3 të këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të caktuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga ligji nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së

Shqipërisë”, i ndryshuar, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

2. Delegimi i kompetencave përfundon në datën 31.12.2020.

3. Ngarkohet z. Emis Çerava, Sekretar i Përgjithshëm i komanduar, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Ibrahimi

VENDIM
Nr. 128, datë 10.8.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRIVE “MAX ENERGY” SHPK, “WINDSBAB” SHPK DHE “SEMAN EOLIK” SHPK PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË ERE-s NR. 114, DATË 9.7.2020, “MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME NGA ERA ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 3 mw PËR VITIN 2019”

Në mbështetje të nenit 16 pika 5, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 144, të “Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 16, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 10.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94/6 prot., datë 5.8.2020, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi kërkesën e shoqërive “Max Energy” sh.p.k., “Windsbab” sh.p.k. dhe “Seman Eolik” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 114, datë 9.7.2020, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi të instaluar deri në 3 mw për vitin 2019”,

konstatoi se:

- Në datën 9.7.2020, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 114, u shpreh për:



1. *Miratimin e çmimit të blerjes të energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 mw prej 75.64 euro/mwh, për vitin 2019.*

2. *Çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këta prodhues, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga ERE.*

- Në datë 23.7.2020, në ERE janë paraqitur shkresat e protokolluara me nr. 994/1 prot., dhe nr. 994/2 prot., 94/3 prot., të shoqërive “Max Energy” sh.p.k., “Windsbab” sh.p.k. dhe “Seman Eolik” sh.p.k., me anë të të cilave këto shoqëri i janë drejtuar ERE-s me kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 114/2020.

- Në këtë vendimmarrje të Bordit të ERE-s, është parashikuar se: “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Për këtë vendim mund të kërkolet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike”.

- me shkresën e ERE-s nr. 994 prot., datë 21.7.2020, subjektet të cilët kanë kërkuar rishikimin e vendimit sipërcituar kanë marrë dijeni në lidhje me këtë vendimmarrje.

- Kërkesa e shoqërive për rishikimin e vendimit të ERE-s, rezulton të jetë paraqitur brenda afateve ligjore të parashikuara në nenin 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

- Në kuptim të parashikimeve të nenit 3, pika 7, germa “a” dhe germa “b”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, kërkuar legjitimohen si palë në këtë procedurë për shkak të interesit të drejtpërdrejtë në këtë vendimmarrje.

- Në kuptim të kërkesës së shoqërive dhe sa deklaruar në këto kërkesa për rishikim, nuk është përcjellë provë e re, e që si e tillë duhet të çojë ERE-n drejt marrjes së një vendimi të ndryshëm në lidhje me parashikimet e vendimit objekt rishikimi.

Ajo që përbën në thelb kërkesën e subjekteve për rishikim të vendimit të ERE-s lidhet me:

1. Kërkesën për përcaktimin e një çmimi më të lartë dhe jo të mbështetur në metodologji, ndryshe nga ai që rezulton nga përllogaritjet e ERE-s bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era.

2. Ndryshimin/shfuqizimin e pikës 2, të vendimit të ERE-s nr. 114/2020.

- Në lidhje me kërkesën e parë, rezulton se, për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi deri në 3 mw për vitin 2019, është vlerësuar e arsyeshme të njihen komponentët për llogaritjen e LCOE-së që rezultojnë nga planet e biznesit të projekt zbatimeve të paraqitura së fundmi nga tri shoqëritë të cilat janë mbajtëse të miratimeve përfundimtare për ndërtimin e impianteve eolike. Në zbatim të sa më sipër dhe nisur nga eksperiencia e krijuar për përcaktimin e çmimit të blerjes të energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet prodhuese fotovoltaike deri në 2 mw, është përllogaritur çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 mw. Nga zbatimi i formulës për llogaritjen e LCOE-së, për përcaktimin e çmimit për impiantet eolike, rezulton një çmim prej 75.64 euro/mwh.

- Kërkesa e shoqërive për përcaktimin e një çmimi të ndryshëm nga ai që rezulton si rrjedhojë e kalkulimit të komponentëve të formulës përllogaritëse të përcaktuar në “Metodologjinë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, është e paarsyeshme dhe e pambështetur në legjislacionin në fuqi.

- Në lidhje me këtë kërkesë, vlerësojmë se shoqëritë nuk kanë konstatuar apo pretenduar asnjë pasaktësi në përllogaritjet e ERE-s në përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë nga kjo kategori impiantesh prodhuese, por kanë kërkuar vendosjen e një çmimi të ndryshëm, bazuar në nevojën për mbështetje më të madhe financiare nëpërmjet një çmimi më të lartë, çka nuk është në kompetencën e ERE, e cila ka vetëm detyrën që, në kuptim të Metodologjisë së sipërcituar të përllogarisë dhe përcaktojë çmimin mbi të dhënat e disponuara.

- Në lidhje me kërkesën e dytë, që lidhet me ndryshimin/shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të ERE-s nr. 114/2020, sqarojmë se, ERE ka përcaktuar në këtë vendim se: 2. Çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këta prodhues, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga ERE.

- Siç edhe sjellë në vëmendje në vendimin e ERE-s objekt rishikimi, në kontratat respektive midis palëve e më konkretisht nenit 8, pika 2 dhe



nenit 10, pika 4, është parashikuar se, vlerësimi i investimeve mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve, në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit për ndërtimin e parkut eolik...

- Vendosja e dispozitës së parashikuar në pikën 2, të vendimit të ERE-s nr. 114/2020, në asnjë rrethanë nuk synon/tenton të cenojë të drejtën e garantuar të subjekteve kërkuar (shoqëritë “Max Energy” sh.p.k., “Windsbab” sh.p.k. dhe “Seman Eolik” sh.p.k.), që ky çmim të jetë i pandryshuar për 15 vitet në vijim, por nisur pikërisht nga fakti që Shqipëria aktualisht është i vetmi vend në Evropë ku nuk është instaluar deri më sot asnjë impiant me erë, e për rrjedhojë eksperiencë dhe të dhënat në lidhje me ecurinë e investimit në këtë lloj teknologjie të prodhimit të energjisë elektrike mungojnë, ERE ka vlerësuar se në rast se aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi do të ndryshojnë, ky vendim, dhe vetë çmimi i përcaktuar mund të jenë objekt rishikimi, por pa përkeqësuar pozitën apo çënuar parimin e sigurisë juridike për palët e interesit. Kontrata e lidhur midis “Max Energy” sh.p.k., dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të datës 3.10.2019 me nr. 1879 rep., dhe nr. 1767 kol; kontrata e lidhur midis “Windsbab” sh.p.k., dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të datës 11.11.2019 me nr. 7337 rep., dhe nr. 2915 kol; Kontrata e lidhur midis Bashkimit të Shoqërive “Seman Sunpower” sh.p.k., dhe “Sonne” sh.p.k., dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të datës 11.11.2019 me nr. 7336 rep., dhe nr. 2914 kol., të cilat janë baza ligjore që legjitimojnë të drejtën e kërkuarve për të disponuar mbi të drejtën e shitjes së energjisë së prodhuar, referuar nenit 8, pika 2 dhe nenit 10 pika 4, mund të pësojë ndryshime.

- Dispozitat e neneve 144 e në vijim të rishikimit, në Kodin e Procedurave Administrative lidhen me situatën kur palët e interesit kërkojnë anulimin ose ndryshimin e një akti administrativ me justifikimin se ai/ajo nuk ka qenë në gjendje të paraqesë rrethana specifike apo prova të reja me shkresë brenda procedurës administrative. *Parakusht i rishikimit është që pala nuk ka qenë në gjendje të paraqesë rrethana apo prova me shkresë ose të veçanta brenda procedurës administrative ose procedurës të ankimit.*

- “Provat e reja” në kuptim të Kodit të Procedurës Administrative janë vetëm dokumente në formë të shkruar, të cilat janë të përshtatshme për të provuar pretendimet e palëve lidhur me fakte të rëndësishme të deklaruara nga pala në procedurën hetimore.

- Në lidhje me sa më sipër, nuk rezulton të jetë e provuar as shkresësisht e as nëpërmjet shpjegimeve në lidhje me rrethana të konstatuara pas vendimmarrjes së ERE, asnjë shkak ligjor që i vlerësuar në cilësinë e provës të çojë ERE-n në rishikimin e vendimit objekt rishikimi.

- ERE, me iniciativën e saj, mund të orientojë/shpjegojë subjektet kërkuar, në lidhje me rrethanat kushtet dhe afatet e parashikuara në dispozitivin e vendimit të ERE-s nr. 114/2020, konkretisht, pikën 2 të tij, me qëllim shmangien e çdo keqinterpretimi nga palë të tjera të asaj që është sanksionuar në këtë dispozitë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Max Energy” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 114/2020 “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi të instaluar deri në 3 MW për vitin 2019”, si të pambështetur në prova të reja të tilla që mund të çojnë Bordin e ERE-s në rishikimin e tij.

2. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Windsbab” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 114/2020 “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi të instaluar deri në 3 MW për vitin 2019”, si të pambështetur në prova të reja të tilla që mund të çojnë Bordin e ERE-s në rishikimin e tij.

3. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Seman Eolik” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 114/2020 “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi të instaluar deri në 3 MW për vitin 2019”, si të pambështetur në prova të reja të tilla që mund të çojnë Bordin e ERE-s në rishikimin e tij.

4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 129, datë 10.8.2020

**MBI MIRATIMIN E DISA SHITESAVE
DHE NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 190, DATË
23.11.2017, “MBI MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN
E PAGESAVE TË RREGULLIMIT
PËR TË LICENCUARIT”**

Në mbështetje të nenit 16 pika 5, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 14, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenit 16 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 10.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 94/9 prot., datë 7.8.2020, për gatitur nga Grupi i Punës, Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr. 190, datë 23.11.2017, të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- me vendimin nr. 139, datë 24.9.2019, Bordi i ERE-s është shprehur mbi “Fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr. 190, datë 23.11.2017 “Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

- Neni 17, pika 4, e ligjit nr. 43/2015, ngarkonte ERE-n me detyrimin për përcaktimin dhe miratimin e pagesave rregullatore që paguhën prej të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse në të cilën përcaktohej, gjithashtu, se: “Pagesa duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar”.

- ERE, me anë të shkresës nr. 631, datë 7.9.2019, njoftoi të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror mbi këtë vendimarrje, si dhe kërkoi prej tyre dhënien e sugjerimeve dhe opinioneve lidhur me ndryshimet e propozuara brenda 15 ditëve nga dita e marrjes dijeni.

- Në përgjigje të saj shoqëritë u përgjigjën me shkresat si më poshtë vijojnë:

- me shkresën nr. 631/2 prot., datë 22.10.2019, “Kastrati Energy” sh.p.k. shpreh dakordësinë me shtesat dhe ndryshimet në vendimin nr. 190, datë 23.11.2017 “Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, të propozuara në vendimin nr. 139/2019, të Bordit të ERE-s.

- AAES, me shkresat nr. 631/3 prot., datë 28.10.2019, shprehet se e konsideron mjaft pozitive këtë vendimarrje të Bordit të ERE-s, por e gjykon si të pamjaftueshme, procedurën e iniciuar nga ERE, si dhe propozimet e hartuara për të adresuar në mënyrë shteruese efektet e përllogaritjes së tarifës pas përfundimit të vitit ushtrimor, duke i hequr mundësinë shoqërive që operojnë në tregun e parregulluar që të përshijnë *ex ante* në metodologjinë e përcaktimit të çmimit/njësi edhe vlerën e tarifës rregullatore.

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 631/4 prot., datë 25.10.2019, gjithashtu, ka përcjellë opinionin e saj lidhur me mënyrën transparente që ERE duhet të bëjë alokimin e kostove për secilin aktivitet (shërbimin) rregullator.

- Shoqëria “Albagaz” sh.a., me shkresën nr. 631/5 prot., datë 4.11.2019, shpreh dakordësinë e saj në lidhje me fillimin e procedurave për vendimin e sipërcituar në zbatim të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe shprehet parimisht dakord për këtë draft dhe përmbajtjen e tij.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 631/6 prot., datë 11.11.2019, shprehet parimisht dakord me propozimin e ERE-s.

- Energji ASHTA sh.p.k., në shkresën nr. 631/7 prot., datë 6.12.2019, gjithashtu, ka shprehur opinionin e saj.

- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 631/8 prot., datë 31.12.2019 shprehet dhe vlerëson se “Rregullorja për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë



elektrike”, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

- ERE mbasi filloi shqyrtimin e opinioneve sa më sipër në vijim dhe të seancës dëgjimore teknike të datës 4.11.2019 midis grupit të punës të ngritur për rishikimin e kësaj rregullore dhe palëve të interesit në zbatim të urdhrit të kryetarit të ERE-s, vijoi me analizimin e opinioneve dhe komenteve të palëve të interesit për ndryshime e kësaj rregullore duke vlerësuar mundësinë e akomodimit të opinioneve sa më sipër në lidhje me këtë proces mbështetur në legjislacionin në fuqi.

- Kuvendi i Shqipërisë me anë të ligjit nr. 61/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, shfuqizoi fjalinë e dytë të nenit 17, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, të ndryshuar në të cilën përcaktohej se: “Pagesa duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar”.

- ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse. Pagesa duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar.

- Duke marrë shkas nga opinioni i palëve të interesit sa më sipër, si dhe nisur nga vlerësimet e grupit të punës, mbi mënyrën më të drejtë dhe transparente për përlogaritjen e pagesave rregullatore, vlerësojmë se metoda e përlogaritjes së pagesave të rregullimit e adoptuar nga ERE përpara miratimit të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” është një metodë e drejtë dhe transparente e cila përsëri bazohet mbi të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti i licencuar i shoqërive që ushtrojnë aktivitet në sektorin e energjisë.

- Kjo metodë përlogaritjeje është adaptuar në një sërë vendimarrjesh të ERE-s mbi përcaktimin e pagesave rregullatore ndër vite, nuk është kundërshtuar nga asnjë nga palët e interesit gjatë periudhave të mëparshme dhe adreson kërkesën e palëve të interesit për një metodologji të thjeshtë, të kuptueshme dhe transparente.

Mbështetur në nenin 14, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, ERE përcakton dhe miraton pagesat e aplikimit për licencë dhe pagesat rregullatore për të licencuarit në sektorin e gazit natyror, në përputhje me metodologjinë e miratuar prej saj. Kjo rregullore është plotësuar me dispozita

mbi përcaktimin e pagesave të rregullimit subjekteve që operojnë në sektorin e gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike” miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, si më poshtë:

a) Neni 1 bëhet: rregullorja për përcaktimin e pagesave rregullatore për të gjithë të licencuarit e tregut të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga Enti Rregullator i Energjisë, është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

b) Neni 3 bëhet: objektivi i kësaj rregulloreje të llogaritjes së pagesave rregullatore është, të përcaktojë pagesa rregullatore të veçanta për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, furnizimit, tregtimit dhe operimit të tregut të energjisë elektrike dhe për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e transmetim të gazit natyror, shpërndarjes së gazit natyror, furnizimit të gazit natyror, tregtimit të gazit natyror, operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, operim në impiantet e GNL-së; funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror;

c) Neni 4.1 ndryshon dhe bëhet: pagesa rregullatore – pagesa vjetore që të gjitha shoqëritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror paguajnë për llogari të ERE-S për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore;

d) Neni 4.2 ndryshon dhe bëhet: të licencuar – shoqëri të cilat janë licencuar nga ERE për veprimtaritë sipas pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe pikës 2, të nenit 22 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

e) Shtohet pika 4.4 me përmbajtje: 4.4 Tregu i energjisë – do të thotë tregut të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror në kuptim të ligjit nr. 43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike, I ndryshuar dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.



f) Neni 5, pika 5.1 ndryshon: Kjo rregullore është konceptuar konform nenit 17 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 14, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, ku parashikohet se;

g) Neni 5.2 ndryshon dhe bëhet: pagesa rregullatore, në zbatim të pikës 52, të nenit 3, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe pikës 69, të nenit 4, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, llogaritet dhe mbledhet mbi baza vjetore për çdo shoqëri të licencuar, pavarësisht faktit nëse në momentin e llogaritjes së kësaj pagese shoqëria nuk e ka filluar aktivitetin për të cilin është licencuar;

h) Neni 5.5 ndryshon dhe bëhet: pagesat rregullatore do të miratohen jo më vonë se 60 ditë pas miratimit të buxhetit të ERE-s të vitit aktual.

i) Neni 6.1 ndryshon dhe bëhet: pagesat rregullatore do të llogariten bazuar në peshën specifike që zënë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i çdo të licencuari në vitin paraardhës ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë elektrike, dhe gazit natyror të realizuar për të njëjtën periudhë.

j) Pas nenit 6.1 shtohet neni 6.1.1 me përmbajtje si më poshtë: të ardhurat për efekt të llogaritjes së pagesave rregullatore do të konsiderohen:

a) për shoqëritë e prodhimit të energjisë elektrike – të ardhurat e realizuara nga shitja e energjisë elektrike të prodhuar;

b) për shoqëritë e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike/gazit natyror – të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë / gazit natyror;

c) për shoqëritë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike/gazit natyror – të ardhurat (vlera e shtuar) të realizuara nga shitblerja e energjisë elektrike/gazit natyror.

a. Për shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e operatorit të tregut të energjisë elektrike/gazit natyror – të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar.

b. Për shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror – të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar.

n) Neni 6.3 ndryshon dhe bëhet: për shoqëritë e licencuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, furnizimit dhe tregtimit të energjisë

elektrike dhe gazit natyror që në vitin parardhës nuk kanë pasur aktivitet, pagesa rregullatore do të jetë një shumë fikse prej 100 mijë lekësh.

o) Neni 6.4 ndryshon dhe bëhet: në rastet kur një shoqëri e licencuar në aktivitetet e energjisë elektrike apo gazit natyror, nuk ka paraqitur pasqyrat financiare, sipas afateve të parashikuara në legjislacionit në fuqi, atëherë ERE do të përlogaritet këtë pagesë mbi bazën e vlerësimeve nga të dhëna të marra nga publikime zyrtare.

p) Neni 9 ndryshon dhe bëhet:

9.1 Në rast se i licencuari nuk bën pagesën rregullatore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit të ERE-s mbi përcaktimin e pagesës rregullatore, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 106 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

9.2 Refuzimi i paraqitjes së pasqyrave financiare në kohë ose dërgimi me vonesë i tyre përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen sipas pikës 1, germa “b” nenit 107, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe pikës 1, germa “a”/ii, të nenit 106, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

9.3 Në rast se i licencuari nuk përmbush detyrimin për kryerjen e pagesës rregullatore edhe pas masës së marrë sipas pikës 9.1 e 9.2, të këtij neni, atëherë ndaj tij Bordi mund të fillojë procedurat për heqjen e licencës, siç përcaktuar në pikën 1 (ç), të nenit 42, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe pikës 1 (ç), të nenit 27, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

q) neni 10 ndryshon dhe bëhet: rregullorja për përcaktimin e pagesave rregullatore për të gjithë të licencuarit e tregut të energjisë nga Enti Rregullator i Energjisë, është objekt ndryshimesh apo rishikimi vetëm, me vendimin e Bordit të ERE-s.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve nga marrja dijeni.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare për



veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike dhe brenda 45 ditëve kalendarike për aktivitetet në sektorin e gazit natyror.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

RREGULLORE

MBI PËRCAKTIMIN E MIRATIMIT E PAGESAVE RREGULLATORE

*Miraturar, me vendimin e Bordit nr. 190,
datë 23.11.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 129,
datë 10.8.2020.*

Neni 1 Autoriteti

Rregullorja për përcaktimin e pagesave rregullatore për të gjithë të licencuarit e tregut të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga Enti Rregullator i Energjisë, është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat për llogaritjen e pagesave rregullatore për të gjithë të licencuarit në tregun e energjisë si një nga burimet kryesore të financimit të ERE-s, me qëllim mbulimin e kostove të aktivitetit të rregullimit.

Neni 3 Objektivi

Objektivi i kësaj rregulloreje të llogaritjes të pagesave rregullatore është të përcaktojë pagesa rregullatore të veçanta për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, furnizimit, tregimit dhe operimit të tregut të energjisë elektrike dhe për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, shpërndarjes së gazit natyror, furnizimit të gazit natyror, tregimit të gazit natyror, operimit në

hapësirat e depozitimit të gazit natyror, operim në impiantet e GNL-së; funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror.

Neni 4 Termat e përdorur në metodologji

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin si më poshtë:

4.1 **Pagesa rregullatore** – pagesa vjetore që të gjitha shoqëritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror paguajnë për llogari të ERE-s për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore.

4.2 **Të licencuar** – shoqëri, të cilat janë licencuar nga ERE për veprimtaritë sipas pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

4.3 **Të ardhurat** – nënkuptojnë të ardhurat vjetore të realizuara nga aktiviteti i licencuar, të deklaruara në pasqyrat financiare të audituara referuar Standardeve të Kontabilitetit në fuqi.

4.4 **Tregu i energjisë** – do të thotë tregut të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror në kuptim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

Neni 5 Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

5.1 Kjo rregullore është konceptuar konform nenit 17 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 14, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

a) burimet financiare të ERE-së përbëhen nga pagesat rregullatore, të vendosura nga ajo vetë për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe nga pagesat e licencave;

b) ERE mban llogari të plota për shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi kontabilitetin;

c) ERE përcakton dhe miraton pagesat e aplikimit për licencë dhe pagesat rregullatore për të licencuarit në sektorin e gazit natyror, në përputhje me metodologjinë e miratur prej saj.



5.2 Pagesa rregullatore, në zbatim të pikës 52, të nenit 3, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe pikës 69, të nenit 4, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, llogaritet dhe mblidhet mbi baza vjetore për çdo shoqëri të licencuar, pavarësisht faktit nëse në momentin e llogaritjes së kësaj pagese shoqëria nuk e ka filluar aktivitetin për të cilin është licencuar.

5.3 Pagesa duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar.

5.4 Të licencuarit në zbatim të neneve 45 e 46, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 30, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar dhe në zbatim të kushteve të licencës depozitojnë në ERE deri më datë 31 janar të vitit pasardhës pasqyra të plota për vitin e mëparshëm ushtrimor e më tej deri në datën 30 qershor kopje të audituar të pasqyrave financiare të periudhës së mëparshme nga ku rezulton informacioni mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar që do të përdoren në llogaritjen e pagesave të rregullatore.

5.5 Pagesat rregullatore do të miratohen jo me vonë se 60 ditë pas miratimit të buxhetit të ERE-s të vitit aktual.

Neni 6

Përcaktimi i pagesës rregullatore për të licencuarit në sektorin e energjisë

6.1 Pagesat rregullatore do të llogariten bazuar në peshën specifike që zënë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i çdo të licencuari në vitin paraardhës ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror të realizuar për të njëjtën periudhë.

6.1.1 Të ardhurat për efekt të llogaritjes së pagesave rregullatore do të konsiderohen:

a) **Për shoqëritë e prodhimit të energjisë elektrike** – të ardhurat e realizuara nga shitja e energjisë elektrike të prodhuar.

b) **Për shoqëritë e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike/gazit natyror** – të ardhurat (vlera e shtuar) të realizuara nga shitblerja e energjisë elektrike/gazit natyror.

c) **Për shoqëritë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike/gazit natyror** –

të ardhurat (vlera e shtuar) të realizuara nga shitblerja e energjisë elektrike/gazit natyror.

d) **Për shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e operatorit të tregut të energjisë elektrike/gazit natyror** – të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar.

e) **Për shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror** – të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar.

6.2 Pagesa rregullatore për secilin të licencuar është e barabartë me produktin e peshës specifike të llogaritur sipas pikës 6.1 me vleftën për t'u shpërndarë në buxhetin e ERE-s (pasi të jenë zbritur pagesat fikse nga të licencuarit) të përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

6.3 Për shoqëritë e licencuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror që në vitin paraardhës nuk kanë pasur aktivitet, pagesa rregullatore do të jetë një shumë fikse prej 100 mijë lekësh.

6.4 Në rastet kur një shoqëri e licencuar në sektorin e energjisë elektrike apo gazit natyror, nuk ka paraqitur pasqyrat financiare, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, atëherë ERE do të përlllogaritë këtë pagesë mbi bazën e vlerësimeve nga të dhëna të marra nga publikimet zyrtare.

Neni 7

Korrigjimi

ERE, me paraqitjen e një kërkesë nga të licencuarit në rast të pasaktësive të llogaritjes në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti i licencuar, rillogarit dhe korrigjon pagesën rregullatore të vitit aktual në pagesën rregullatore të vitit pasardhës.

Neni 8

Njoftimi

8.1 ERE, pasi përcakton pagesat rregullatore njofton të licencuarin për vlerën, afatet e pagesës për vitin ushtrimor, vendin e kryerjes së këtyre pagesave dhe penalitetet në rast se kjo pagesë nuk kryhet në kohë.



8.2 Pagesat rregullatore depozitohen nga ERE në një llogari të veçantë, të hapur në një nga bankat që operojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 9
Penalitetet

9.1 Në rast se i licencuari nuk bën pagesën rregullatore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit të ERE-s mbi përcaktimin e pagesës rregullatore, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 107 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 106 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

9.2 Refuzimi i paraqitjes së pasqyrave financiare në kohë ose dërgimi me vonesë i tyre përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen sipas pikës 1, germa “b”, nenit 107, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe pikës 1, germa “a”/ii, të nenit 106, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

9.3 Në rast se i licencuari nuk përmbush detyrimin për kryerjen e pagesës rregullatore edhe pas masës së marrë sipas pikës 9.1 e 9.2, të këtij neni, atëherë ndaj tij Bordi mund të fillojë procedurat për heqjen e licencës, siç përcaktuar në pikën 1 (ç), të nenit 42, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe pikës 1 (ç), të nenit 27, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

Neni 10
Dispozita përfundimtare

Rregullorja për përcaktimin e pagesave rregullatore për të gjithë të licencuarit e tregut të energjisë nga Enti Rregullator i Energjisë, është objekt ndryshimesh apo rishikimi vetëm, me vendimin e Bordit të ERE-s.

VENDIM
Nr. 130, datë 10.8.2020

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN KORRIK 2020

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, (ERE) në mbledhjen e tij të datës 10.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin korrik 2020,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën e saj nr. 6352 prot., datë 7.8.2020, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin korrik 2020, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bashkëlidhur këtij aplikimi, FSHU sh.a. nuk ka paraqitur informacion e detajuar lidhur me procedurat e blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar.

- ERE i është referuar portalit online <https://oshee.al/kalendari-i-ofertave/> të shoqërisë dhe ka nxjerrë në formë elektronike dokumentacionin e detajuar të realizimit të procedurës së blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar sipas periudhës së deklaruar në aplikim.

- Rezulton së është zhvilluar vetëm 1 procedurë për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar (P94) dhe sasia e blerë në tregun e parregulluar është 74,400 MWh me një vlerë totale prej 3,039,240.00 euro.

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar rezulton 5.075 lekë/kWh.



- Për sa i përket kursit të këmbimit, shoqëria FSHU sh.a. deklaron se për llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike ka përdorur kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për datat kur janë realizuar procedurat e blerjes së energjisë elektrike të cilat janë konfirmuar dhe në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

- Bazuar në kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2020, janë vlerësuar sa ato të vitit 2019.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në vendimin nr. 198, datë 12.12.2019 “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifen e shërbimit

të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020” është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV: bazuar në vendimin nr. 199, datë 12.12.2019, të Bordit të ERE-s “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020” është 1.5 lekë/kWh.

- Në zbatim të metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe propozimi i ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja për muajin korrik 2020, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Korrik 2020

Korrik 2020		Aplikim i FSHU sh.a.	Përllogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/ kWh	5.074
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/ kWh	0.15
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	Leke/ kWh	5.23
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/ kWh	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/ kWh	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/ kWh	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		Leke/ kWh	9.27

- Për sa përcautoar për çdo element të formulës përlogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2020, të jetë 9.27 lekë/kWh.

- Në zbatim të pikës 2, të nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, i ndryshuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 233, datë 20.12.2019, parashikohet se në çdo rast ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë të klientët që furnizohen në atë nivel tensioni sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014, kur këtë funksion e ushtron OSHEE/ FSHU.

- Çmimi i miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014, për klientët që furnizohen në nivelin e tensionit 35 kV është 9.5 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 9.5 lekë/kWh për muajin korrik 2020.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 131, datë 10.8.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË
VLERËSIMIT DHE TË PËRZGJEDHJES
SË FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË
FUNDIT NË SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016 “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike”, nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, ERE, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94/5 prot., datë 5.8.2020, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, në sektorin e energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Në nenin 87, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohet se: ERE, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas pikës 1, të këtij neni, cakton Furnizuesin e Mundësisë së Fundit;

- Këshilli i Ministrave, me VKM-në nr. 449, datë 15.6.2016 ka vendosur “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike. Në pjesën III, të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar “Kushtet dhe procedurat për caktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike”, ku parashikohet se deri në përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit sipas këtij vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit;

- me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 115, datë 8.7.2016, mbi përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike, Bordi i

ERE-s ka vendosur që: 1. të përcaktojë përkohësisht OSHEE sh.a. në cilësinë e Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike, nga data 1 korrik 2016, deri në 31.12.2016. 2. Në rastet kur klienti nuk arrin të sigurojë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit, furnizimi si mundësi e fundit kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit sipas parashikimeve të vendimit të Këshilli i Ministrave nr. 449, datë 15.6.2016;

- Në vijim për këtë vendimmarrje, Bordi i ERE-s është shprehur, me vendimin nr. 96, datë 4.7.2017, mbi shtyrjen e afatit të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, “Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”, duke vendosur: 1. Shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 1, të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016.

- Për qëllime të përmbushjes së detyrimeve sa më sipër, është draftuar rregullorja e cila ka për objekt të saj, të caktojë procesin e përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit që i kërkohet të kryejë shërbimin e furnizimit në përputhje me nenin 87, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 449, datë 15.6.2016, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”.

- Elementet që mbahen në konsideratë në hartimin e kësaj rregulloreje, janë parashikimet e nenit 87, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në VKM-në nr. 449, datë 15.6.2016.

- Sa u përket të drejtave dhe detyrimeve të të licencuarit të përzgjedhur si Furnizues i Mundësisë së Fundit dhe klientëve që përfitojnë këtë shërbim janë ato që parashikohen në rregullat për kushtet e shërbimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, dhe kushtet kontraktore të furnizimit me energji elektrike të miratuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit



dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit në sektorin e energjisë elektrike.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 132, datë 10.8.2020

**MBI KUALIFIKIMIN DHE PAJISJEN ME
CERTIFIKATË TË GARANCISË SË
ORIGINËS PËR IMPIANTIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE “HEC BANJË”, TË
SHOQËRISË “DEVOLL
HYDROPOWER” SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 8 dhe 11 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019 dhe nenit 19, germa “d”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar, me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94/1 prot., datë 7.8.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me miratimin e kualifikimit të impiantit dhe pajisjen me “Certifikatë të garancisë së origjinës” për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të Shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 88, datë 20.5.2020, ka filluar procedurën për kualifikimin dhe pajisjen me “Certifikatë të garancisë së origjinës”, për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, me shkresën nr. 684/1 prot., datë 29.5.2020, është kryer njoftimi i vendimit të fillimit të procedurës.

- Shoqëria “OST” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 684/3, datë 12.6.2020, ka përcjellë informacionin në lidhje me marrëveshjen e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. me OST sh.a.

- HEC Banjë ka filluar veprimtarinë e tij si prodhues në datën 3.9.2016.

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., kërkesën për pajisjen me certifikatën e garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”, e ka shoqëruar edhe me dokumentacionin përkatës konform “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar dhe HEC Banjë i shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., përmbush të gjitha kriteret për t’u kualifikuar si impiant prodhues i energjisë elektrike dhe për t’u pajisur me certifikatën e garancisë së origjinës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.

2. Të pajisë me certifikatën e garancisë së origjinës impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për një afat 12-mujor.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së vendimit në ERE dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën



Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 133, datë 10.8.2020

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 51, DATË 26.3.2020 “MBI DISA NDRYSHIME TË PËRKOHSHME NË PROCEDURAT E LICENCIMIT NË USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR NË KUADËR TË MASAVE PAS SHFAQJES SË VIRUSIT COVID-19 DHE SHPALLJES SË GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE NË VENDIN TONË”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 16, të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015 “Për sektorin gazit natyror”, nenit 16, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.8.2020, pas aplikimeve të shoqërisë “Electral” sh.p.k. dhe “Lengarica Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afateve për depozitimin e dokumentacionit për qëllime të aplikimit për rinovimin e licencave, si dhe pas propozimit të anëtares së Bordit, për zgjatjen e afateve të parashikuara në vendimin e përkohshëm të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020 “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”,

konstatoi se:

- Në Republikën e Shqipërisë vijnë masat shtrënguese dhe parandaluese, me qëllim mbrojtjen dhe parandalimin e përhapjes së epidemisë së shkaktuar nga virusit COVID-19, duke përcaktuar,

ndër të tjera, edhe kufizim të disa aktiviteteve që nuk lejohen gjatë gjendjes së pandemisë.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020, i ndryshuar, është vendosur për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, afat, i cili përfundonte në datën 24.7.2020

- Në kuptim të ligjit për sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror, aktivitetet e prodhimit transmetimit, shpërndarjes, furnizimit dhe tregtimit në sektorët respektivë ushtrohen si aktivitete të licencuara nga ERE.

- Qeveria e Shqipërisë ka marrë masa për kufizimin e aksesit të publikut në ambiente me frekuentim të gjerë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, ka vendosur, ndër të tjera: të gjitha licencat që përfundojnë deri më 30 qershor 2020 nuk do t'i nënshtrohen një procesi rinovimi. Këto subjekte kanë detyrimin për dorëzimin e një aplikimi për rinovim licence, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjendjes së epidemisë COVID-19.

- Në vendimin sipërcituar është vendosur zgjatja e afatit për dorëzimin e një aplikimi për rinovim licence vetëm për ato subjekte që u përfundon vlefshmëria e licencës deri më 30 qershor dhe jo afati për rinovim. Aplikimi për rinovim të një licence, duhet të bëhet dy muaj përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së licencës.

- Sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm për procedurën e rinovimit të licencave apo dhe dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e kushteve të licencimit të subjekteve të licencuara me kusht nga ERE, bëhet i vështirë.

- E drejta e garantuar nëpërmjet këtij akti normativ me karakter të përkohshëm të ERE-s, duhet të shtrihet edhe për ato subjekte për të cilat afati i aplikimit për rinovimin e një licence i përfundon gjatë kohëzgjatjes së efekteve juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51/2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51/2020 si më poshtë:

a) Pika 2 e vendimit 51/2020 bëhet: subjektet e licencuara gjatë kësaj periudhe kanë detyrimin për t'i paraqitur jo më vonë se data 1.9.2020, vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, pika 2, germa “d”, të rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar, me vendimin e Bordit nr. 215/2019, si dhe nenit 9, pika 1, germa “d”, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror” miratuar nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 97, datë 4.7.2017.

b) Pika 3 e vendimit nr. 51/2020 bëhet:

Të gjitha licencat afati i të cilave ka përfunduar deri më 30 qershor 2020, ose subjektet afati i aplikimit për rinovimin e licencave, i korrespondon periudhës deri më 30 qershor 2020, kanë të drejtën për dorëzimin e një aplikimi për rinovim licence, jo më vonë se data 1.9.2020.

c) Pika 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51/2020 bëhet:

Pezullimin e afateve të plotësimit të kushteve që lidhen me plotësimin e dokumentacionit, të përcaktuara në licencat e dhëna nga ERE në një nga veprimtaritë e parashikuara në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, deri jo më vonë se data 1.9.2020.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare, për veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike dhe brenda 45 ditëve kalendarike për aktivitetet në sektorin e gazit natyror.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 134, datë 10.8.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY”
SHPK, NR. 306, SERIA FK 15, NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË ERE-s, NR. 105, DATË 18.8.2015**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “d”; nenit 5, pika 1, germa “d”; nenit 8, nenit 9, nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, vendimit të Bordit të ERE-s nr. 133 datë 10.8.2020 “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020 ‘Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 10.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94/2 prot., datë 3.8.2020, të përparuar nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 974, datë 13.7.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nr. 306, seria FK15, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, data 18.8.2015.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në



datën 26.6.2008 është e regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

- Në nenin 16, pika 1, të rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Bordi i ERE-s, në datën 10.8.2020, me vendimin nr. 133 u shpreh për disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51/2020, ku mes të tjerave vendosi: të gjitha licencat afati i të cilave ka përfunduar deri më 30 qershor 2020, ose subjektet, afati i aplikimit për rinovimin e licencave, i të cilave ka përfunduar deri më 30 qershor 2020, kanë të drejtën për dorëzimin e një aplikimi për rinovim licence, jo më vonë se data 1.9.2020.

- Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” “c”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Neni 16, pika 1, germa “a”

Formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1

- **germa “b”** (të dhëna identifikuese për aplikuesit). **Plotësuar pjesërisht.**

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE formatin e aplikimit të plotësuar në të gjithë zërat, sipas kërkesave të kësaj **pike të rregullores.**

Neni 9, pika 2:

- **germat “a”/“b”** (akti i themelimit/statuti).

Plotësuar pjesërisht.

Akti i themelimit dhe Statuti i shoqërisë janë depozituar në formatin fotokopje, ndaj në zbatim të nenit 8, pika 3, të rregullores, do t’i kërkohej shoqërisë që këtë dokumentacion ta depozitojë origjinal ose fotokopje të noterizuar/njësuar me origjinalin.

- **germa “c”** (vërtetim për regjistrimin dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB). **Plotësuar pjesërisht.**

Certifikata e regjistrimit është paraqitur në formatin fotokopje, ndaj në zbatim të nenit 8, pika 3, të rregullores, do t’i kërkohej shoqërisë që këtë dokumentacion ta depozitojë origjinal ose fotokopje të noterizuar/njësuar me origjinalin.

- **germa “d”** (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). **Pa plotësuar.**

Neni 16, pika 1, germa “c”

Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3.

- **germa “b”**, paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilanci të këtyre të fundit). **Plotësuar pjesërisht.**

Pasqyrat financiare për vitet ushtrimore 2017, 2018 dhe 2019 janë depozituar në formatin fotokopje, ndaj në zbatim të nenit 8, pika 3, të rregullores, do t’i kërkohej shoqërisë që këtë dokumentacion ta depozitojë origjinal ose fotokopje të noterizuar.

- **germa “c”** (dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qarte vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.) **Pa plotësuar.**

Shoqëria nuk ka paraqitur dokument në lidhje me këtë kërkesë të rregullores. Edhe pse nga pasqyrat financiare të depozituara rezulton që bilanci e shoqërisë janë mbyllur me fitim, gjithsesi, duke u bazuar në këtë kërkesë specifike të rregullores vlerësojmë se shoqëria duhet të bëjë saktësim të vlerave monetare për financimin dhe strukturën e financimit të kësaj veprimtarie.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

**Neni 9, pika 4.7:**

- **germa “a”** (të dhëna për sigurimin e energjisë elektrike për furnizimin e klientëve); **pa plotësuar.**

- **germa “b”** (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj).

Pa plotësuar.

- **germa “c”** (lista e kontratave aktuale dhe të mëparshme /nëse ka, për blerjen dhe sigurimin e energjisë elektrike). **Pa plotësuar.**

- **germa “d”** (informacion i detajuar tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e këtyre kontratave). **Pa plotësuar.**

- **germa “e”** (sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi). **Pa plotësuar.**

- **germa “g”** (dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'u ofrohen klientëve). **Pa plotësuar.**

- **germa “h”** (të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar (kategoritë, nënkategoritë, numri i konsumatoreve, sasia e energjisë në GËh në vitin e I, II, III, IV dhe V), lidhja në Un, fuqia e instaluar e konsumatorëve, aktiviteti (familjarë, buxhetorë, privatë). **Pa plotësuar.**

- **germa “i”** (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët). **Pa plotësuar.**

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10 dhe nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 306, seria FK15, të shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, datë 18.8.2015, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 135, datë 10.8.2020

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 71, DATË 22.4.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KALISI HYDROPOWER” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et “VELESHICA 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 5801 *kw* DHE “VELESHICA 2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 8116 *kw*, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 13917 *kw*”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 10.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94/3 prot., datë 4.8.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., mbi plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 3, të vendimit nr. 71, datë 22.4.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 71, datë 22.4.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Kalisi Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et ‘Veshica 1’ me kapacitet të instaluar 5801 *kw* dhe ‘Veshica 2’, me



kapacitet të instaluar 8116 *kw*, me kapacitet total të instaluar 13917 *kw*”, vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Veleshica 1”, me kapacitet të instaluar 5801 *kW*, si dhe “Veleshica 2” me kapacitet të instaluar 8116 *kw*, me kapacitet total 13917 *kw*, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për truallin ku do të ushtrohet veprimtaria jo më vonë se 3 (tre) muaj përpara përfundimit të afatit të saj.

3. Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., të depozitojë në ERE jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë COVID-19 vërtetimet e lëshuara nga prokuroria dhe gjykata e rrethit të Tiranës për shoqërinë dhe administratorin e saj.

4. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën nr. 655, datë 22.4.2020, u njoftua shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. në lidhje me vendimmarrjen e ERE-s për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, u njoftua shoqëria në lidhje me detyrimin për të depozituar në ERE jo më vonë se një muaj nga përfundimi i pandemisë COVID-19 (brenda datës 23.7.2020), vërtetimet e lëshuara nga gjykata dhe prokuroria e rrethit të Tiranës për shoqërinë dhe administratorin e saj.

- Më tej, me shkresën e ERE-s nr. 655/1 prot., datë 17.7.2020, është rikujtuar shoqëria në lidhje me plotësimin në afat të detyrimit të sipërcituar

- Në përgjigje, me shkresën e datës 22.7.2020, protokolluar në ERE, me nr. 655/2 prot., datë 22.7.2020, shoqëria ka depozituar në ERE

vërtetimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, nga të cilët nuk rezulton të ketë proces penal për shoqërinë dhe administratorin e saj, si dhe vërtetimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nga të cilët nuk rezulton të ketë procedim penal në ngarkim të shoqërisë dhe të administratorit të saj.

- Sa më sipër, rezulton se shoqëria ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e munguar, duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 3, të vendimit nr. 71, datë 22.4.2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 71, datë 22.4.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Veleshica 1” me kapacitet të instaluar 5801 *kw* dhe “Veleshica 2”, me kapacitet të instaluar 8116 *kW*, me kapacitet total të instaluar 13917 *kw*”, shfuqizohet.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë